

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Ramiz Kuqi dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F.B. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), me bazë juridike anulimin e vendimit, të organit të paditur, duke vendosur, lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1713/2015, të datës 16.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.01.2019, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e paditësit F.B., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, e datës 22.01.2018, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1713/2015, i datës 16.11.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e refuzon kërkesëpadinë e paditësit F.B., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi KPMShCK A/02/936/2015, i dt.02.09.2015, si e pa bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk i ka administruar provat e propozuara nga paditësi. Paditësi ka kërkuar nga gjykata administrimin e provave duke ftuar dërguesin e postes në seancë që të deklarohej se në çfarë forme në cilin vend dhe a i është dërguar personalisht aktvendimi i KPMK paditësit apo dikujt tjetër? A është në dokument nënshkrimi i paditësit, i dërguesit të postës apo i kujt është ai nënshkrim? Kjo nga fakti se paditësi është i bindur se ky dokument me të drejtën e ankimit nuk i është dorëzuar personalisht paditësit, se ky dokument nuk është dorëzuar në shtëpi të paditësit anëtarëve të paditësit por ky dokument është dorëzuar dikund në stacion të autobusëve, që është në kundërshtim me dispozitat ligjore të pranimit dorëzimit të dokumenteve me të drejtë ankimi. Andaj pas administrimit të provave i propozon Gjykatës së Apelit që ta aprovoj ankesën si të themeltë, ta shfuqizoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë A.nr.1713/2015 të dt.16.11.2017 dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe neni 194 i LPK-së(ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 63 të LKA-së), gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e organit të paditur KPMSHC A/02/396/2015, të dt.02.09.2015, është hedhë poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A/02/396/2015, e datës 13.08.2015, e parashtruar nga ankuesi F.B..

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi, ka ushtruar padi në gjykatë me datë 07.10.2015, kundër të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës, duke pretenduar se vendimi i të paditurës është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, me dt.16.11.2017, në prani të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: Organi i shkallës së dytë me të drejtë ka konstatuar se afati për parashtrimin e ankesës në kuptim të Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe të ankesave nr.05/L2011, i cili ka përcaktuar se ankesa parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit. Atëherë organi i shkallës së dytë e ka hedhur poshtë ankesën A 02/396/2015 dt.13.08.2015, e parashtruar nga pala paditëse për shkak se ka konstatuar se paditësi ka parashtruar ankesën me dt.13.08.2015 në KPMSHCK, në kundërshtim me afatin e përcaktuar sipas rregullores së sipërpërmendur, mbi këtë bazë kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se momenti kur ankuesit i ka filluar ti rrjedhë afati për ankim është dt.13.07.2015 ka pranuar vendimin me nr.01 nr.077-139444 të dt.06.07.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës dhe data e fundit kur ankuesi ka mundur të parashtrroj ankesë në KPMSHCK ka qenë 11.08.2015. Prandaj gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga ana e të paditurës, drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje genësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës iu ka referuar Ligjit për Procedurën Administrative përkatësisht nenit 130 par.1 i cili përcakton se: “Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: pala është njoftuar për aktin administrativ me të cilin vlerëson se i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes”. Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Ndërsa sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në

kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, se ankesa nuk rezulton nga faktet e vërtetuara dhe provat e vlerësuara, andaj thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Sa i përket pretendimeve tjera ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktgjykimit të atakuar duke pretenduar në shkeljet e theksuara si në ankesë, Gjykata e Apelit vlerëson se janë të pabazuara sepse, me nenin 130 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative thuhet se: “Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: pala është njoftuar për aktin administrativ me të cilin vlerëson se i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes. Paditësi vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Komunale të dt.06.07.2015, e ka pranuar me dt. 13.07.2015, ndërsa ankesën e ka dorëzuar me dt.13.08.2015, pra jashtë afatit të paraparë me ligj. Pretendimet e paditësit se “dokumenti me të drejtën e ankimit nuk i është dorëzuar personalisht paditësit, se ky dokument nuk është dorëzuar në shtëpi të paditësit anëtarëve të paditësit por ky dokument është dorëzuar dikund në stacion të autobusëve”, ky pretendim nuk qëndron për arsye se paditësi në ankesën e datës 13.08.2015, ka deklaruar se vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Komunale 01 nr.007-139444 të dt.06.07.2015, e ka pranuar më dt. 13.07.2015. Prandaj, nuk kemi të bëjmë as me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, si që parasheh neni 194 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet e paditësit, në ankesë dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara në prova, të pa ndikim për tu ndryshuar gjendja faktike dhe për tu vendosur çështja në mënyrë tjetër, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë në procedurë gjyqësore dhe nga organi administrativ përfundimtar KPMSHCK, sepse nga të cekurat më lartë, si dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vërtetohet se në këtë çështje juridike administrative të paditësit drejtë është vlerësuar ligjshmëria e aktit administrativ përfundimtar në procedurë administrative dhe nuk është cenuar ligji në dëm të tij.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i Ligjit për procedurën kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.103/2018, me datë 23.01.2019

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi